



VENDIM

Nr. 55, Datë 18.04.2017

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LIÇENCIMIN E SHOQËRISË “ALB ENERGY MARKET” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d” të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “e”; 5, pika 1 gërma “e”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për dhenie, Modifikimi, Transferimi, Rinovimi ose Heqjen e Licensave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” e Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin nr.96 datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 18.04.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për licensimin e shoqërisë “ALB ENERGY MARKET” sh.p.k, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut;

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “ALB ENERGY MARKET” sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat (“a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b” “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licensimin e shoqërisë “ALB ENERGY MARKET” sh.p.k, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE
Petrit AHMETI